

ÇKA QËNDRON PAS AKUZAVE TË OSMANIT KUNDËR LISTËS SERBE?

FAQE 4-5



Analistët politikë kanë vlerësuar se deklarata e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, se Lista Serbe po përpiket të bllokojë krijimin e institucioneve të reja,

duhet të shihet si mesazh politik. Qëllimi i saj, sipas tyre, është të tregojë pajtueshmëri me Lëvizjen Vetëvendosje të kryeministrit në detyrë, Albin

Kurti, në mënyrë që të sigurojë mbështetje edhe për një mandat tjetër presidencial, pas prillit të 2026-s, kur i përfundon mandati aktual


24 VJET
NGA SULMI
TERRORIST NË
SHBA, KOSOVA
QËNDRON
KRAH MIQVE
AMERIKANË F. 3



RAMA PREZANTON
KABINETIN
E RI QEVERTAR,
TREGON TRI
OBJEKTIVAT
KRYESORE NË
MANDATIN E KATËRT
QEVERTISËS F. 5



NËNSHKRUHEN KONTRATAT
ME 78 PËRFITUESIT E SKEMËS SË
GRANTEVE 'PZHRB 2025' F. 8



ZHEGROVA PREZANTOHET TE JUVE:
PËRFAQËSOJ TË GJITHË SHOQIPTARËT F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht –Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.PK.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL

BUNJAKOL

EUROFASADË

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

CHARLIE KIRK, AKTIVIST KONSERVATOR, VDES PAS TË SHTËNAVE NË NJË NGJARJE NË KOLEGJ NË SHBA

UASHINGTON, 11 SHTATOR - Charlie Kirk, shefi dhe bashkëthemelues i organizatës rinore konservatore, Turning Point USA, u vra me armë zjarri të mërkurën mbrëma gjatë një tubimi në një kolegji në Utah.

Kirk njihej gjithandej për podkastet e tij, ishte luftëtar kulture dhe aleat i presidentit amerikan, Donald Trump.

Ai e udhëhoqi një përpjekje për ta rindërtuar strategjinë e Partisë Republikane për nxjerrjen e votuesve në zgjedhjet e vitit 2024, duke u bazuar në idenë se kishte mijëra mbështetës të Trumpit që rrallë votonin, por që mund të bindeshin të votonin.

Vrasja e tij është shembulli më i fundit i dhunës politike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

që prek një gamë të gjerë ideologjish politike dhe të dy partitë kryesore.

Kirk po fliste në një debat të organizuar nga Turning Point USA në Universitetin “Valley” në Utah, kur autoritetet thanë se dorasi hapi zjarr nga një çati aty pranë.

Video të postuara në rrjetet sociale e shfaqin Kirkun duke folur me mikrofon dore nën një tendë të bardhë. Një e shtënë dëgjohet dhe Kirku e çon dorën e djathtë në qafë, ndërsa gjaku i rrjedh nga ana e majtë e saj.

Universiteti i “Valley” në Utah është universiteti publik më i madh i këtij shteti, me 47.000 studentë, dhe ndodhet rreth 64 kilometra në jug të kryeqytetit Salt Lake City.

Si republikanët, ashtu edhe demokratët e dënuan menjëherë vrasjen e Kirkut.

Trump urdhëroi uljen e flamujve në gjysmë shtizë dhe nxori një proklamata presidenciale. Presidenti, i cili vetë u plagos lehtë në vesh kur u qëllua gjatë fushatës zgjedhore vitin e kaluar, tha se kishte marrëdhënie të ngushta me Kirkun.

Ai e përshkroi Kirkun në Truth Social si një “djalë të mrekullueshëm nga koka deri te këmbët. Zoti e bekoftë!”


Guvernatori demokrat i Kalifornisë, Gavin Newsom, i cili në mars kishte ftuar Kirkun në podkastin e tij, shkroi në X: “Sulmi ndaj Charlie Kirk është i neveritshëm, i poshtër dhe i papranueshëm”.



NË FRANCË PROPOZOHEM NDALIMI I RRJETEVE SOCIALE PËR FËMIJËT NËN 15-VJEÇARË

PARIS, 11 SHTATOR - Një raport i Parlamentit të Francës për rrjetin social, TikTok, ka rekomanduar të enjten ndalimin e rrjeteve sociale për fëmijët nën moshën 15-vjeçare dhe vendosjen e një “orari policor digjital” për të rinjtë e moshës 15 deri në 18-vjeçare, në përpjekje për ta frenuar ndikimin negativ mbi shëndetin e tyre. “Një ndalim i tillë do të dërgonte një mesazh si për fëmijët, ashtu edhe për prindërit, se rrjetet sociale nuk janë të padëmshme para moshës 15-vjeçare”, tha për AFP Laure Miller, raportuese e komisionit parlamentar hetimor.

Komisioni, i ngritur në mars, ka intervistuar familje viktimash, menaxherë të platformave sociale dhe influencerë për të analizuar algoritmin e TikTok-ut, një aplikacion jashtëzakonisht i



popullarizuar mes të rinjve, i cili “kopjohet nga rrjete të tjera sociale”, sipas Millerit.

Ai u krijua pas proceseve ligjore kundër TikTok-ut në Francë në fund të vitit 2024, pas një padie nga shtatë familje që akuzuan platformën se ekspozon fëmijët

ndaj përbajtjeve që mund t'i nxisin drejt vetëvrasjes. “Është e vështirë për ne prindërit ta kontrollojmë këtë gjë”, tha për AFP Geraldine, 52-vjeçare, dhe një nga paditëset që kërkoi të mbetej anonime.

Ajo humbi vajzën e saj Penelope,

18-vjeçare, në shkurt të vitit 2024, e cila kreu vetëvrasje. Më pas, ajo zbuloi se vajza kishte publikuar dhe shikuar në TikTok video me përbajtje që nxisnin vetëlëndim. TikTok pretendon se siguria e të rinjve është prioriteti kryesor i kompanisë.

Raporti paralajmëron se, nëse brenda tri vjetësh rrjetet sociale nuk pëmbushin detyrimet ligjore, sidomos ato të përcaktuara në Rregulloren Evropiane për Shërbimet Digjitale (DSA), mund të shkohet deri në ndalimin e përdorimit për personat nën 18-vjeçare.

Disa vende të BE-së, përfshirë Francën, Spanjën dhe Greqinë, kohët e fundit i kanë bërë thirrje Brukselit për rregullim më të rreptë të platformave online për fëmijët, për shkak të shqetësimeve

mbi varësinë, bullizmin digjital dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes.

Menaxherët e TikTok-ut, i cili është pronë e kompanisë kineze ByteDance, theksuan se sistemi i vëzhgimit i bazuar në inteligjencën artificiale ka mundësuar heqjen e 98 për qind të përbajtjeve që shkelin rregullat e përdorimit në Francë vitin e kaluar.

Megjithatë, sipas komisionit, përbajtjet e dëmshme vazhdojnë të qarkullojnë, duke shkaktuar, ndër të tjera, humbje të vëmendjes, çrregullime të gjumit dhe probleme me vetëvlerësimin. Për të rinjtë e moshës 15 deri në 18-vjeçare, raporti propozon një “orë policore digjitale”, sipas së cilës rrjetet sociale do të bëheshin të paqasshme nga ora 22:00 deri në orën 08:00.

POLONIA KUFIZON TRAFIKUN AJROR PËRGJATË KUFIRIT LINDOR, NJË DITË PASI RRËZOI DRONË TË DYSHUAR RUSË

VARSHAVË, 11 SHTATOR - Polonia ka vendosur kufizime në trafikun ajror përgjatë kufijve të saj lindorë me Bjellorusinë dhe Ukrainën, njoftoi të enjten Komanda Operative e Forcave të Armatosura.

Ky vendim vjen mes tensioneve të shtuara një ditë pasi disa dronë shkelën në hapësirën ajrore të këtij vendi anëtar të NATO-s.

Polonia rrëzoi dronë të dyshuar rusë në hapësirën e saj ajrore mëngjesin e së mërkurës me mbështetjen e avionëve të aleatëve të saj të NATO-s.

Kjo ishte hera e parë që një anëtar i aleancës ushtarake perëndimore ka hapur zjarr

gjatë luftës së Rusisë në Ukrainë. “Me kërkesë të Komandës Operative të Degëve të Forcave të Armatosura ... do të vendosen kufizime në trafikun ajror në pjesën lindore të Polonisë në formën e zonës së kufizuar EP R129”, tha Agjencia Polake e Navigimit Ajror në një komunikatë të publikuar të mërkurën në mbrëmje.

Kufizimet u futën në fuqi të mërkurën në mesnatë dhe do të zbatohen deri më 9 dhjetor, tha ajo.

Nga lindja deri në perëndim të diellit, fluturimet në zonën e kufizuar janë të ndaluara, përveç avionëve të drejtuar nga



njerëz që operojnë sipas një plani fluturimi me transponderë përkatës dhe që

mbajnë komunikim dypalësh me autoritetet ajrore, tha agjencia.

Kufizimet nuk vlejnë për fluturime ushtarake dhe disa fluturime të posaçme me mision të caktuar dhe thirrje të veçanta. “Nga perëndimi deri në lindjen e diellit ka një ndalim të plotë fluturimesh, me përjashtim të avionëve ushtarakë... Në zonën EP R129 ka një ndalim 24-orësh për fluturimet e mjeteve ajrore civile pa pilot”, tha agjencia. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha të mërkurën se dronët e saj kishin kryer një sulm të madh ndaj objekteve ushtarake në Ukrainën perëndimore, por nuk kishte planifikuar të godiste asnjë shënjestër në Poloni.

24 VJET NGA SULMI TERRORIST NË SHBA, KOSOVA QËNDRON KRAH MIQVE AMERIKANË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Presidentja Vjosa Osmani, kryeparlamentari Dimal Basha, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, së bashku edhe me përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë bërë homazhe te pllaka përkujtimore që i dedikohet viktimave të sulmit terrorist ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sot 24 vjet më parë, 19 terroristë, me katër avionë, vranë 2977 amerikanë, në mesin e të cilëve tre shqiptarë: Mon Gjonbalaj, Simon Dedvukaj dhe Rrok Camaj, në një sulm të tmerrshëm terrorist që i ndryshoi edhe marrëdhëniet ndërkombëtare, por njëkohësisht edhe paralajmëroi rreziqet e mëdha që na presin në këtë shekull.

Presidentja, Vjosa Osmani, ka thënë Kosova me krenari ka qëndruar dhe qëndron me ShBA-në, jo vetëm në kujtim dhe nderim të viktimave por për ta luftuar në mënyrë efektive dhe pa ndalur terrorizmin kudo që ndodhët ai.

“Jemi së bashku me kryetarin e Kuvendit, me kryeministrin dhe përfaqësuesen e ambasadës së ShBA-së për t’i kujtuar edhe një herë të gjitha viktimat e sulmit të tmerrshëm terrorist të 11 shtatorit në ShBA dhe njëkohësisht për të nderuar edhe heroizmin e treguar nga të

gjithë ata që u përgjigjën ndaj këtij sulmi duke rrezikuar edhe jetën e vet për të shpëtuar edhe jetën e të tjerëve. Kosova me krenari ka qëndruar dhe qëndron me ShBA-në, jo vetëm në kujtim dhe nderim të viktimave por për ta luftuar në mënyrë efektive dhe pa ndalur terrorizmin kudo që ndodhët ai. Jemi krenarë që jemi partnerë të palëkundur të ShBA-ve”, ka thënë Osmani.

Pas nderimeve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, ka thënë se sulmi i 11 shtatorit 2001 ishte sulm ndaj vlerave të lirisë dhe demokracisë, prandaj, siç tha ai, populli i Kosovës është përkrah popullit amerikan, duke u solidarizuar në këtë përvjetor të 24-të. “Populli ynë shqiptar gjendet krah popullit amerikan. Jemi shumë mirënjohës dhe solidarizohemi me ta në këtë ditë të vështirë, ku 24 vjet më parë afër 3 mijë viktima, qytetarë amerikanë, pësuan, ndër ta edhe tre shqiptarë”, ka thënë ai.

Kreu i Kuvendit shtoi se Kosova qëndron krah vlerave të përbashkëta që ndan me popullin amerikan për lirinë dhe demokracinë dhe kundër çfarëdo terrori që i kundërshton apo i lufton këto vlera. Shteti i Kosovës, shtoi kryetari Basha, do të qëndrojë krah ShBA-ve në luftimin e terrorizmit. “Ne prapë mbesim aleatë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe do të qëndrojmë



krah tyre në luftimin e terrorizmit”, ka thënë Basha. Edhe kryeministri Kurti ka thënë se shprehin solidaritetin me popullin amerikan, ngushëllimet për familjet e viktimave, përfshirë aty edhe familjet e 403 zjarrfikësve e policëve që ranë në krye të detyrës në përpjekje për t’i shpëtuar njerëzit të cilin ishin të kurrthuar në ndërtesat që po digjeshin e po shembeshin. “Në vend të ‘Kullave Binjake,’ tani aty është ‘Kulla e Lirisë’ në Nju Jork, e cila është një ndërtesë

edhe më e lartë duke simbolizuar kësaj që forca e demokracisë dhe sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut gjithmonë ngadhënjëjnë mbi brutalitetin dhe mizorinë e terroristëve të të gjitha ngjyrave”, ka thënë Kurti.

Homazhe te pllaka përkujtimore që i dedikohet viktimave të sulmit terrorist ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë bërë edhe liderët e partive tjera politike. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, së bashku me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe te kjo pllakë përkujtimore, duke theksuar se 11 shtatori 2001 ndryshoi përgjithmonë historinë moderne. “Një sulm barbar kundër Shteteve të Bashkuara tronditi botën, por nuk e theu shpirtin amerikan, shpirt që mishëron qëndresën, lirinë, demokracinë dhe fitoren. Bashkë me kolegë, bëmë homazhe te pllaka përkujtimore kushtuar viktimave të asaj dite. Për popullin tonë, miqësia me Amerikën është e shenjtë. Në këtë përvjetor, ashtu si çdo ditë, qëndrojmë krah miqve tanë amerikanë dhe botës demokratike, duke nderuar me respekt të thellë ata që humbën jetën”, ka thënë Haradinaj.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka shkruar në “Facebook” se 11 shtatori mbetet një plagë e thellë për botën demokratike dhe një datë që asnjëherë nuk do ta

harrojmë. “Si Kosovë, e dimë mirë çfarë do të thotë të rrezikohet liria, prandaj e çmojmë sakrificën, unitetin dhe forcën me të cilën ShBA, 24 vite më parë, iu përgjigj terrorit. Sot, duke kujtuar viktimat dhe heronjtë e asaj dite, riafirmojmë përkushtimin tonë të palëkundur për të mbrojtur lirinë, paqen dhe demokracinë, vlera që na lidhin përjetësisht me miqtë dhe aleatët tanë amerikanë”, ka thënë Krasniqi.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se ky sulm nuk ishte vetëm një goditje ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por një sfidë brutale ndaj vetë vlerave themelore mbi të cilat ngrihet shoqëria demokratike, lirisë, paqes dhe bashkëjetesës. “Ishte një përpjekje e dhunshme për të cenuar mënyrën e jetesës së lirë e të hapur, që popujt demokratikë ndajnë kudo në botë. Sot, 24 vite më pas, përulemi me respekt para kujtimit të viktimave dhe shprehim solidaritet të plotë me familjet e tyre. Kjo ditë na kujton se beteja kundër ekstremizmit dhe terrorizmit është përgjegjësi e përbashkët, që kërkon unitet dhe vendosmëri të vazhdueshme. Kosova mbetet e palëkundur në miqësinë e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vazhdon të angazhohet për të mbrojtur e promovuar vlerat demokratike që na bashkojnë”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



FSK-ja nderon viktimat e 11 shtatorit në ShBA

Prishtinë, 11 shtator- Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) në shenjë nderimi dhe përkujtimi të viktimave të terrorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, njësitë e Forcës

së Sigurisë së Kosovës kanë lëshuar të enjten flamujt në gjysmë shtize në të gjitha kazermat e FSK-së, duke përkujtuar kështu viktimat e sulmit terrorist që ndodhi më

11 shtatorit të vitit 2001. “FSK-ja dhe populli i Kosovës do të jenë për herë, në krah të miqve tanë në ditë të vështira e në ditë festash”, ka njoftuar FSK-ja.



ÇKA QËNDRON PAS AKUZAVE TË OSMANIT KUNDËR LISTËS SERBE?

Analistët politikë kanë vlerësuar se deklarata e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, se Lista Serbe po përpiqet të bllokojë krijimin e institucioneve të reja, duhet të shihet si mesazh politik. Qëllimi i saj, sipas tyre, është të tregojë pajtueshmëri me Lëvizjen Vetëvendosje të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, në mënyrë që të sigurojë mbështetje edhe për një mandat tjetër presidencial, pas prillit të 2026-s, kur i përfundon mandati aktual



PRISHTINË, 11 SHTATOR - Deklaratën e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, se Lista Serbe po përpiqet të bllokojë formimin e institucioneve të reja, analistët e interpretojnë kryesisht si një mesazh politik. Qëllimi i saj, sipas tyre, është të tregojë pajtueshmëri me Lëvizjen Vetëvendosje të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, në mënyrë që të sigurojë mbështetje edhe për një mandat tjetër presidencial, pas prillit të 2026-s, kur i përfundon aktual. Sociologu nga Prishtina, Artan Muhaxhiri, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se pa mbështetjen e Kurtit, Osmani “nuk ka asnjë shans” për mandatin e ardhshëm, dhe se deklaratat e saj të fundit duhet kuptuar në këtë kontekst politik. “Qëndrimet e saj të fundit përkohësisht kryesisht me ato të Kurtit - në lidhje me problemin me nënkryetarin e Kuvendit nga Lista Serbe dhe vendimin e pritur të Gjykatës Kushtetuese”, thotë Muhaxhiri. Në anën tjetër, politologu nga Beograd, Ognjen Gogiq, i cili ndjek nga afër zhvillimet në Kosovë, beson se Osmani mban përgjegjësi të madhe për krizën institucionale disamujore pas zgjedhjeve të shkurtit, sepse, siç thotë, nuk ka reaguar në kohën e duhur. “Partitë shqiptare kishin një rol shumë më të madh [në

konstituimin e Kuvendit]. Osmani kontribuoi në këtë situatë me mosveprimin e saj. Është Vetëvendosje ajo që tani po e bllokon formimin e institucioneve, sepse udhëhoqi votimin [për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit]”, thotë Gogiq për “Radion Evropa e Lirë”. Kryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha, u zgjodh në fund të gushtit, pas një krize politike disamujore, që pasoi zgjedhjet parlamentare të shkurtit. Në ato zgjedhje, asnjë parti nuk mori mjaftueshëm vota për të formuar vetë institucionet e reja. Tani, një krizë e re duket sërish në horizont, pasi Basha shpalli në mënyrë të njëanshme përfundimin e konstituimit të Kuvendit, edhe pse nënkryetari i pestë nga komuniteti serb nuk ishte zgjedhur. Për këtë arsye, Lista Serbe iu drejtua Gjykatës Kushtetuese javën e kaluar. Kjo parti - më e madhja e serbëve në Kosovë, që fitoi 9 nga 10 vendet e rezervuara për komunitetin serb në Kuvend - konsideron se Basha ka shkelur Kushtetutën, duke e ndarë votimin për nënkryetarët nga komunitetet joshumicë dhe ai serb. Lëvizja Vetëvendosje i bëri

thirrje Kushtetueses që ta shpallë të papranueshme kërkesën e Listës Serbe. Edhe presidentja Osmani vlerësoi se Kuvendi nuk duhet të bllokohet për këtë çështje dhe pret që Gjykata Kushtetuese të mos vendosë në favor të Listës Serbe, por të konfirmojë se Kuvendi është konstituuar edhe pa zgjedhjen e nënkryetarit të pestë serb. Përgjegjësinë për bllokimin e formimit të institucioneve të reja, Osmani e kaloi te Lista Serbe, ndërsa analisti politik, Muhaxhiri, beson se këtë e bëri “për të forcuar në mënyrë strategjike aleancën e saj me Kurtin dhe Vetëvendosjen”.

A ka Lista Serbe kapacitet për të bllokuar formimin e institucioneve?

Muhaxhiri beson se Lista Serbe është “një subjekt specifik politik në Kosovë, që formalisht dhe me Kushtetutë, ka fuqi të madhe politike në lidhje me proceset më të rëndësishme shtetërore”. “Megjithatë, fuqia e saj autonome për të marrë vendime nuk ekziston, sepse është e varur nga një sërë faktorësh të ndërsjellë - vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë”, shton Muhaxhiri. Ai thekson se Kushtetuta e

Kosovës është e qartë për rolin e deputetëve serbë në proceset e formimit të institucioneve. “Kjo është një pasqyrë direkte e parimeve themelore të Planit Ahtisaari [mbi bazën e të cilit është shpallur pavarësia e Kosovës]. Prandaj, nuk është realiste të thuhet se Lista Serbe mund të bllokojë formimin e institucioneve me vetiniciativë. Çdo përpjekje e tillë paradoksale vetëm do ta forconte atë”, thotë Muhaxhiri. Sipas tij, vetëm Gjykata Kushtetuese e Kosovës “mund ta shpërndajë gjithë mjegullën populiste që ka kapur hapësirën publike që nga zgjedhjet e 9 shkurtit”. Gogiq thekson, gjithashtu, se Lista Serbe në këtë situatë nuk merr asnjë vendim dhe, në përputhje me rrethanat, nuk mund të bllokojë formimin e institucioneve të reja. “Osmani nuk dëshiron të marrë përgjegjësi, ajo nuk do ta kritikojë Vetëvendosjen, ndaj është më e lehtë për të që ta fajësojë Listën Serbe. Nuk ishte vetëm Lista Serbe që u indinjua që nuk u zgjodh nënkryetari i pestë, por edhe opozita shqiptare. Ata thanë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese nëse Osmani i jep mandatin [për formimin e Qeverisë së re] Kurtit”, thotë Gogiq. Partia e dytë më e madhe në

Kuvendin e Kosovës pas Lëvizjes Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës, beson se Basha nuk duhej ta kishte përfunduar seancën konstituive, sepse Kryesia e Kuvendit nuk u zgjodh në përbërje të plotë kushtetuese. Lidhja Demokratike e Kosovës - partia e tretë më e madhe në Kuvend - tha gjithashtu se Kuvendi nuk është konstituuar ende dhe se ai nuk mund të funksionojë e as të marrë vendime, pa u përfunduar procesi i konstituimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

Cila është zgjidhja?

Muhaxhiri thotë se për të dalë nga kriza aktuale, është e nevojshme që udhëheqësit e Kosovës të “gjejnë vizionin, guximin dhe forcën për t’iu rikthyer politikës normale dhe racionale”. “Politika të mbështetet në patriotizmin kushtetues dhe të lidhet me vlerat kushtetuese dhe parimet demokratike. Mund të tingëllojë si klishe, por, në fakt, është mënyra e vetme për zhblokim të menjëhershëm dhe për përparim afatgjatë shoqëror e institucional në Kosovë”, thotë Muhaxhiri. Mendim të ngjashëm ndan edhe Gogiq. “Zgjidhja është të

RAMA PREZANTON KABINETIN E RI QEVERTAR, TREGON TRI OBJEKTIVAT KRYESORE NË MANDATIN E KATËRT QEVERTISËS

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

TIRANË, 11 SHTATOR - Kryeministri Edi Rama ka prezantuar në Asamblenë Kombëtare të PS-së emrat e kabinetit të ri qeveritar për katër vitet e ardhshme.

Ai gjatë kësaj asambleje ka renditur edhe tri objektivat e tij për katër vitet e ardhshme qeverisëse. “Programi ri qeverisë nuk ka qenë kurrë më i qartë dhe konkret. Detyra jonë si mazhorancë nuk ka qenë kurrë më e qartë se në këtë mandat të katërt të PS-së për Shqipërinë 2030. Të mbyllim negociatat në 27 muajt e ardhshëm, të mundësojmë deri në fund të mandatit ratifikimin në 27 parlamentet e vendeve anëtare, të ngremë deri në fund të dekadës flamurin e Skënderbeut dhe Ismail Qemalit në Bruksel. Këto nuk janë tri stacione, por tri majat që duhen kapur njëra pas tjetrës në kohë për të realizuar ngjitjen e nisur kahershëm të Shqipërisë për në shtëpinë e familjes së saj, të fatit të shkruar të së ardhmes së saj. Kapja e tyre nuk është as e shkruar nga fati apo Zoti, ndodh nga puna durimi e vendosmëria e 400 e kusur njerëzve që janë sot në këtë sallë. Yjet e fatit janë rreshtuar si kurrë asnjëherë në favorin e Shqipërisë”, ka thënë Rama.

Duke folur për kabinetin e ri qeveritar. “Nga reflektimet për të shkruar në mandatin e katërt dua të ndaj me ju mendimin se me 83 mandatet që na dhanë shqiptarët nuk kemi zgjedhje tjetër vetëm të prodhojmë një fuqi e të drejtojmë vendin si të ishim në mandatin e parë. Një kabinet me energji të reja. Duhet të kërkojmë nga vetja një domosdoshmëri, një shtysë e forcë nxitëse për të parë gjithçka që kemi bërë me syrin e atij që kanë ngarkuar për ta bërë siç duhet një punë të bërë jo mirë e jo kënaqshëm nga dikush tjetër.



Na duhet një vullnet i ri për të sjellë në mandatin e katër një qasje, një forcë si të ishte i pari, duke nxjerrë nga vetja një vete të re. Nuk mjafton grup i ri parlamentar, duhet një qasje e re ndaj problemeve të vjetra dhe sfidave të reja. Një forcë kompakte dhe vëllazëri si skuadër kampione, që janë fuqia e talentit dhe disiplinës”, ka deklaruar Rama.

Ai ka bërë me dije se Niko Peleshi është propozuar për drejtimin e Kuvendit të Shqipërisë, ndërkaq Taulant Balla kryetar i Grupit Parlamentar të PS-së.

Rama propozon Ogerta Manastirliun për drejtimin e Bashkisë së Tiranës

Kryeministri Edi Rama ka njoftuar edhe për zgjedhjet e parakohshme për Bashkinë e

Tiranës. Ai ka propozuar për kryetare të Bashkisë ministren e Arsimit, të mandatit të kaluar, Ogerta Manastirliu. “Sot kemi një kryetar bashkie i zgjedhur tri herë, i dënuar jo për detyrën si kryetar. I janë nxjerrë edhe biseda me familjarët nga telefoni i burgut. Kjo nuk ndodh në asnjë vend demokratik. Diktatorial, jo e jo. Është shkelja më e hapur dhe më flagrante në shpërdorim të detyrës, nga ana e tyre që duhet të mbajë nën kontroll hetimet. Tirana ka punë të mëdha dhe të panumërta, përditë e përnatë. Nuk i heq asnjë meritë kryetares në detyrë për sa ka bërë në këto 7 muaj. E falënderoj për përkushtimin. Por sot ne duhet të marrim një vendim politik, për t'i hapur rrugë zgjedhjeve për kryetarin e bashkisë në Tiranë. Mendoj se Ogerta Manastirliu është njeriu i duhur për drejtimin e Bashkisë Tiranë”, ka thënë Rama.

Kabineti i ri qeveritar ‘Rama 4’

Zëvendëskryeministër,
ministër i Infrastrukturës
dhe Energjisë
Belinda Balluku

Ministër i Brendshëm
Albana Koçiu

Ministër për Evropën dhe
Punët e Jashtme
Elisa Spiropali

Ministër i Mbrojtjes
Pirro Vengu

Ministër i Financave
Petrit Malaj

Ministër i Turizmit, Kulturës
dhe Sportit
Blendi Gonxhja

Ministër i Mjedisit
Sofjan Jaupaj

Ministër i Arsimit
Mirela Kumbaro

Ministër i Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale
Evis Sala

Ministër i Ekonomisë dhe
Inovacionit
Delina Ibrahimaj

Ministër i Drejtësisë
Besfor Lamallari

Ministër i Bujqësisë dhe
Zhvillimit Rural
Andis Salla

Ministër i Shtetit për
Marrëdhëniet me Parlamentin
Toni Gogu

Ministër i Shtetit për
Administratën Publike dhe
Antikorrupsionin
Adea Pirdeni

Ministër Shteti dhe
Kryenegociator për BE
Majlinda Dhuka

Ministër i Shtetit për
Pushtetin Vendor
Ervin Demo

tregohet pjekuri dhe përgjegjësi më e madhe. Kjo është e pashpjegueshme - ajo që ata bëjnë për muaj të tërë. Nuk ka zgjidhje kushtetuese-gjyqësore nëse keni një situatë ku deputetët nuk duan t'i formojnë institucionet. Kur shkruhen ligje, llogaritet që deputetët do të duan të marrin kontrollin e institucioneve, dhe këtu kemi një ikje nga përgjegjësia”, thotë Gogiq.

Më 7 shtator, Lëvizja Vetëvendosje emëroi udhëheqësin e saj, Albin Kurti, si mandatar për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Me atë rast, Kurti kritikoi Gjykatën Kushtetuese, duke thënë se ajo vepron në mënyrë të njëanshme, përkatësisht në favor

të partive shqiptare, të cilat në përbërjen e kaluar parlamentare ishin në opozitë. Gjykata Kushtetuese reagoi përmes një deklarate, ku tha se pavarësia dhe paanshmëria e saj mbrohen nga Kushtetuta dhe se asnjë institucion, parti politike apo individ nuk mund të ndërhyjë në punën e saj. Kreu i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë bëri thirrje për respektimin e pavarësisë së gjyqtarëve, ndërsa Ambasada gjermane në Kosovë u bëri thirrje aktorëve dhe institucioneve politike të respektojnë Gjykatën Kushtetuese dhe vendimet e saj, duke thënë se pavarësia e gjyqësorit është gurrthemeli i sundimit të ligjit.

Reagimet e shoqërisë civile

Disa pjesëtarë të shoqërisë civile reagues pas deklaratës së presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, se Kuvendi i Kosovës nuk mund të bllokohet për faktin se nuk është zgjedhur një nënkryetar nga radhët e komunitetit serb dhe se Lista Serbe po përpiqet të bllokojë formimin e institucioneve të reja.

Agon Maliqi, i cili drejton organizatën joqeveritare “Sbunker”, tha se presidentja Osmani ishte “absolutisht në nivelin e detyrës” gjatë krizës politike dhe institucionale,

“duke e kthyer zyrën e unifikuesit të popullit në një mjet politik personal”. “Nëse me këto manovra partizane mendon se mund të sigurojë mbështetje për mandat të dytë, i ka bërë vetes antireklamën më të madhe të mundshme”, shkroi Agon Maliqi në “Facebook”.

Publicisti Veton Surroi tha se komuniteti serb nuk e ka bllokuar, nuk ka vënë veto dhe nuk e ka penguar konstituimin e Kuvendit të Kosovës, por, me propozimet e tij për nënkryetarin, i ka dhënë shumicës mundësinë për të zgjedhur përbërjen e plotë të Kryesisë së Kuvendit. “Shumica nuk e ka zgjedhur asnjë kandidat të propozuar nga dy subjektet politike, që përfaqësojnë

komunitetin serb. Kështu ka penguar kompletimin e Kryesisë së Kuvendit dhe njëkohësisht përmbushjen e një të drejte kushtetuese të komunitetit serb”, shkroi Surroi në “Facebook”.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi reagoi gjithashtu. “Letra e presidentes Osmani drejtuar Gjykatës Kushtetuese është një deklaratë e fuqishme politike. Fatkeqësisht me argumentim të dobët kushtetues dhe juridik”, shkroi Miftaraj në “Facebook”, duke shtuar se Gjykata Kushtetuese “nuk mund ta bazojë aktgjykimin në deklarata politike dhe udhëzime, pa ndonjë vlerë apo argument kushtetues dhe juridik”.

OSMANI E MOHON SE MBROJTJA E SAJ E AFËRT E ARRESTOI KAMERAMANIN: SHUMË KËRCËNIME DREJTOHEN PËR FËMIJËT E MI

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka mohuar të enjten se mbrojtja e saj e afërt e kishte arrestuar kameramanin e një mediumi lokal pranë një shkolle private ku ndjekin mësimet vajzat e saj në Prishtinë.

Kameramani i portalit Paparaci, Jetmir Muji, ishte mbajtur për disa orë në qendrën policore në kryeqytet, pasi ishte ndaluar derisa po xhironte për një raportim për shkollimin e vajzave të presidentes të mërkurën. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës shprehi alarmim dhe shqetësim me ndalimin e tij, duke e cilësuar “arbitrar”.

Osmani i thirri në takim gazetarët të enjten, ku dha sqarime për ngjarjen, duke thënë se është “gënjeshtër tjetër se kinse mbrojtja ime e afërt e ka arrestuar një gazetar”. “Unë vetë kam kërkuar nga mbrojtja ime e afërt që të mos i prekin [gazetarët] me dorë. Ata nuk arrestojnë gazetarë, kanë qenë në kryerjen e detyrës zyrtare”, tha ajo.

Ajo tha se “incizimi i paaautorizuar është vepër penale”, duke shtuar se te shkolla private ku vajzat e saj ndjekin mësimin, “ka qenë shenja që ndalohet incizimi i paaautorizuar”.

Portali Paparaci tha se nuk ka publikuar pamje të dy vajzave të presidentes.

Prokurori i cili hetoi këtë rast dhe urdhëroi lirimin e Mujit, Rrahim Podvorica, tha për Kallxo.com se ky rast nuk ndërlidhet me vepër penale. “Mua, kur më kanë njoftuar ma



kanë shpjeguar gjendjen. Më kanë thënë që këtu nuk ka vepër penale, sepse e ka bërë incizimin në vend publik. Në këto rrethana unë iu kam thënë që ta lirojnë personin në fjalë. Për momentin nuk ka pasur elemente që të hapet rast. Në ato rrethana nuk ka pasur elemente të veprës penale”, tha Podvorica.

Osmani theksoi të enjten se i ka dërguar vajzat në shkollë private për shkak se ajo publike, “Ismail Qemali”, ku deri tani ndiqnin mësimet ato, nuk plotësonte kushtet e sigurisë të kërkuara nga organet kompetente. “Është ndryshe kur një shkollë ka vetëm një hyrje, ndryshe kur janë shumë hyrje. Madje ju vetë keni raportuar për rreziqet e ndryshme në shkolla, për armët, thikat, drogën”, tha Osmani.

Ajo gjithashtu pretendoi se ka

marrë shumë kërcënime dhe e kritikoi gjyqësorin për “mosndërmarrjen e masave”. “Ka një kërcënim që ka ardhur nga serbët në Twitter (tani X) dhe shumë e shumë kërcënime të tjera që zakonisht drejtohen për fëmijët e mi. Është hera e vetme që në historinë e Kosovës, nuk kanë marrë asnjë masë. Ju e dini që shumë mirë që çdo politikan kur kërcënohet i shohim shumë shpejt të akuzuarit para gjykatës. Dhe unë i përgëzoj institucionet që bëjnë një gjë të tillë, mirëpo është hera e vetme që në historinë e vendit tonë që një president ka dhjetëra kërcënime dhe asnjë person nuk është arrestuar”, deklaroi ajo.

Osmani ka sqaruar deklaratën e saj që ngjalli reagime duke theksuar se nuk ka thënë se gazetarët janë objekt hetimi nga

institucionet e sigurisë, por se hetimet lidhen me rastin e Millan Radoiqiqit, dhe në kuadër të tyre janë përfshirë edhe persona të tjerë.

Presidentja shtoi se nuk ka përmendur emra konkretë për të mos penguar hetimet në zhvillim dhe theksoi se është në kompetencë të institucioneve të sigurisë të përcaktojnë se kush është subjekt i hetimeve. “Unë nuk ua determinoj institucioneve të sigurisë hetimet dhe nuk mund të dalë me emra sepse do t'i pengoja ato. Por ata që e kanë mizën pas veshit, e dinë që e kanë. Në momentin që institucionet e sigurisë më thonë që nuk pengohet hetimi nëse unë i them emrat, do ta bëja. Po them që do të shokoheshit po t'i dinit emrat”, u shpreh Osmani.

AGK: Akuzat dhe insinuatat e Osmanit rrezikojnë sigurinë fizike të gazetarëve

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka theksuar se presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani ka vazhduar edhe këtë të enjte me deklarata thellësisht të papërgjegjshme për postin që mban, duke lidhur “disa gazetarë” me “Radojçiqët” dhe me “grusht-shtet”. AGK-ja e dënon ashpër retorikën akuzese dhe nxitëse të presidentes Osmani gjatë konferencës për shtyp, pasi që ajo rrezikon direkt sigurinë fizike të gazetarëve. “Osmani u është referuar sërish raporteve të AKI-së për të forcuar akuzat 'për disa gazetarë', për të cilat AGK mendon se vënë në pikpëyetje sigurinë juridike, jo vetëm të gazetarëve, por edhe të secilit qytetar të Kosovës. AGK-ja fton organet e sigurisë të deklarohen për këto akuza kaq të rënda, që shërbejnë si intimidim i hapur ndaj gazetarëve, në përpjekje për të ndaluar punën e tyre për të bërë pyetje në interes të publikut. AGK-ja e fton sërish presidenten Osmani që të heqë dorë nga praktika jodemokratike e sulmeve ndaj gazetarëve dhe medieeve, dhe të luajë rolin e saj kushtetues që garanton lirinë e medias dhe shprehjes”, thuhet në reagimin e AGK-së.

KOSOVA MERR KONTROLLIN E OBJEKTIT NË GRAÇANICË KU VEPRONTE POSTA E SERBISË

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Posta e Kosovës ka marrë kontrollin e një objekti në Graçanicë, në afërsi të Prishtinës, ku deri më 15 janar të këtij viti ndodhej Posta e Serbisë. Ajo u mbyll në kuadër të një aksioni të gjerë për shuarjen e institucioneve në jug të Ibrit, që funksiononin sipas sistemit të Serbisë.

Kosova i konsideron institucionet serbe paralele dhe ilegale, ndërsa mbyllja e tyre nisi në fillim të vitit 2024, pavarësisht kritikave të komunitetit ndërkombëtar se së pari duhej gjetur një zgjidhje alternative për ofrimin e shërbimeve për qytetarët, të cilët kryesisht janë nga komuniteti serb.

Serbët e Kosovës marrin të ardhura të ndryshme nga buxheti i Serbisë, disa prej të cilave u janë paguar pikërisht në sportelet e Postës së Serbisë, si shtesat për fëmijë apo për nënat,

pensionet, ndihmat sociale e të tjera.

Aktualisht nuk dihet nëse Posta e Kosovës do të hapë një filial të ri në objektin e marrë, apo do ta përdorë atë për qëllime të tjera. Institucionet e Kosovës ende nuk janë deklaruar për aksionin e sotëm.

Drejtori i Postës së Serbisë për Kosovë, Ivan Millojeviq, i cili ishte i pranishëm sot gjatë marrjes së objektit nga Posta e Kosovës dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), u tha gazetarëve se në mes të korrikut u ndryshua pronari në kadastrin e Kosovës, dhe e cilësoi këtë si “uzurpim”, pasi “kemi dëshmi se këtë postë e kemi ndërtuar vetë në vitin 2004”. “Aty ekzistonte një postë e vogël, e vjetër, prej rreth tridhjetë metrash katrorë, ndërsa ajo që shihni sot, ishte qendra e Postës së Serbisë në



Kosovë”, tha Millojeviq, duke e cilësuar atë si “të marrë në mënyrë të paligjshme”. “Mesazhi im është se do të luftojmë me të gjitha mjetet ligjore për ta dëshmuar këtë në gjykatë. Por, e dini si është kur kadia edhe të padit, edhe të gjykon”, shtoi ai.

“Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar MINT-it me kërkesë për t'i komentuar deklaratat e Millojeviqit, por deri në publikimin e këtij lajmi nuk ka marrë përgjigje. Përveç Postës së Serbisë, gjatë dy viteve të fundit janë mbyllur

edhe Banka Kursimore Postare, Banka Kombëtare e Serbisë, drejtoritë e Fondit të Pensioneve dhe Sigurimeve Invalidore, qendrat për punë sociale, ndërmarrjet publike komunale, organet e përkohshme komunale dhe shumë të tjera.

Partneritet i fortë dhe miqësi e qëndrueshme mes Policisë së Kosovës dhe FBI-së

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha ka pritur të enjten në një takim njoftues Atasheun e ri Ligjor të FBI-së, Brendan Collins, i cili mbulon Kosovën me seli në Sofje të Bullgarisë. Në këtë vizitë, Collins ishte i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të FBI-së nga Sofja dhe përfaqësues të Ambasadës së

ShBA-së në Kosovë. Drejtori i Përgjithshëm e falënderoi Collinsin për vizitën e tij në Policinë e Kosovës dhe i uroi suksese në pozitën e re si Atashe Ligjor i FBI-së. Gjatë takimit u diskutua për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit mes Policisë së Kosovës dhe FBI-së. Drejtori i Përgjithshëm

deklaroi se ky bashkëpunim ka qenë gjithmonë i shkëlqyer dhe ka prodhuar rezultate të prekshme në fushën e sigurisë. Ai shprehu gatishmërinë e tij për të forcuar më tej këtë partneritet në të ardhmen. Theks i veçantë u vu mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe fenomeneve të tjera me



interes të përbashkët. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për të forcuar partneritetet ndërkombëtare në funksion të sigurisë së qytetarëve.

FILLON SHTYPJA E FLETËVOTIMEVE PËR ZGJEDHJET LOKALE

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka filluar shtypja e fletëvotimeve të zgjedhjeve lokale për kryetarë të komunave dhe për Kuvende Komunale, të cilat do të mbahen më 12 tetor. Shtypja e fletëvotimeve po realizohet në shtypshkronjën e dokumenteve me siguri të lartë, “Cetis”, në Celje të Sllovenisë. Ky proces po zhvillohet sipas standardeve ndërkombëtare, nën mbikëqyrjen e një delegacioni të KQZ-së të udhëhequr nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi, me pjesëmarrjen e anëtarëve Alban Krasniqi e Muharrem Nitaj, si dhe stafit të Sekretariatit të KQZ-së. Gjithashtu, përveç fletëvotimeve, do të shtypen edhe broshurat me listat e kandidatëve, të cilat do të jenë të



disponueshme për votuesit në vendvotime gjatë ditës së zgjedhjeve. Në fazën e parë janë duke u shtypur fletëvotimet për votimin jashtë Kosovës për 43,993 shtetas të Kosovës, të cilat, KQZ

do të sigurohet që t’ua dërgojë përmes postës, ndërkohë do të vazhdohet me shtypjen e fletëvotimeve për procesin e votimit brenda vendit. Në mbledhjen e mbajtur më 7 shtator, KQZ mori vendim që për

raundin e parë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave të shtypen 1,800,410 fletëvotime dhe po aq, 1,800,410, edhe për zgjedhjet për Kuvende Komunale. Në këtë numër përfshihen fletëvotimet për vendvotimet e

rregullta, votimin me kusht, Votimin e Personave e Nevoja të Veçanta, fletëvotimet rezervë dhe për votimin me postë. Në këtë proces zgjedhor, do të shtypen 13% apo 268,688 fletëvotime më pak se numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote, që sipas Listës Votuese të certifikuar nga KQZ është: 2,069,098. Sipas të dhënave nga Lista Votuese, numri i qytetarëve me të drejtë vote në vendvotime, në Republikën e Kosovës është 2,025,105 votues, ndërkaj numri i qytetarëve që janë regjistruar për të votuar me postë nga jashtë Kosovës është 43,993 votues. Procesi zgjedhor në Republikën e Kosovës, do të organizohet në 938 Qendra të Votimit me gjithsej 2,625 vendvotime, prej të cilave 910 Qendra të Votimit për votimin e rregullt me 2,571 vendvotime dhe 38 Qendra të Votimit për votimin me kusht me gjithsej 54 vendvotime.

KOSOVA NGRE AKTAKUZË NDAJ NJË BURRI TË DYSHUAR PËR SPIUNAZH PËR SERBINË



PRISHTINË, 11 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj H.S., për veprën penale “Spiunazh”. I pandehuri H.S., akuzohet se nga nëntori i vitit 2009, e deri në momentin e arrestimit më 06.05.25, ka bashkëpunuar me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Republikës së Serbisë e njohur si BIA. Sipas aktakuzës, H.S., më 22.11.2015 kishte udhëtuar në Siri, duke ju bashkuar organizatës terroriste “ISIS”.

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se H.S. kishte dërguar informacione tek zyrtarët e BIA-së, në lidhje me numrin e pjesëmarrjes së shqiptarëve në “ISIS”, organizimin e tyre dhe në cilat pjesë të Sirisë operonin ata. Ndërsa, pas kthimit në Kosovë, dhe vuajtjes së burgut për pjesëmarrje në organizata terroriste, i njëjti kishte vazhduar të takohej në Serbi me zyrtarët e BIA-së, më konkretisht me drejtorin për

Luftimin e Terrorizmit I.B., dhe të përcjell informata tjera të rëndësishme. Sipas aktakuzës, si shpërblim për këto informacione, zyrtarët e BIA-së e paguanin H.S deri në 700 euro në muaj. Prokuroria Speciale i ka propozuar Gjykatës vazhdimin e masës së paraburgimit, dhe pas shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri të shpallet fajtor për veprat penale që i vihen në barrë dhe ndaj tij të shqiptohet dënim konform ligjeve në fuqi.

Kuvendi Komunal i Mitrovicës miraton buxhetin për vitin 2026

MITROVICË, 11 SHTATOR - Nën drejtimin e kryesueses, Vesa Broja, dhe në prani të kryetarit të komunës, Bedri Hamza, asamblistëve dhe drejtorëve komunal, të enjten është mbajtur seanca e 41-të e rregullt e Kuvendit të Komunës. Fillimisht kryesuesja Broja

ka propozuar rendin e ditës për miratim, me ç’rast pika e gjashtë është larguar nga rendi i ditës. Në vazhdim u miratuan këto pika të rendit të ditës; Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; Draft-buxheti për vitin 2026 vlerësimet për 2027 dhe

2028; Propozim-vendim për plotësim dhe ndryshim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0021659-2/25 dt. 28.04.2025, Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për përkrahje financiare, si dhe Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2025.



Nënshkruhen kontratat me 78 përfituesit e skemës së granteve 'PZHRB 2025'

Prishtinë, 11 shtator - Ministria e Zhvillimit Rajonal ka organizuar ceremoninë e nënshkrimit të kontratave me 78 përfituesit e Skemës së Granteve në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB 2025. Ceremonia u hap nga zëvendësministri në detyrë i Zhvillimit Rajonal, Elldin Uglari, i cili në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se është kënaqësi e veçantë që në emër të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal të nënshkruajnë kontratat me përfituesit e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

2025. “Kjo skemë grantesh për vitin 2025 do të mbështesë gjithsej 78 përfitues, me synim krijimin e vendeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe ngritjen e kapaciteteve prodhuese në vend”, ka thënë ai. Në fund të fjalës së tij, Uglari uroi përfituesit për zbatimin me sukses të projekteve të tyre, duke theksuar se investimi në sektorin e prodhimit mbetet prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës si një nga fushat më të rëndësishme për zhvillimin e vendit. Ndërsa zëvendësekretarja e



Përgjithshme e MZHR-së, Refike Sulçevsi, i uroi përfituesit për punë të mbarë dhe suksese

gjatë implementimit të projekteve, duke falënderuar njëkohësisht stafin e Ministrisë

për angazhimin e tyre të palodhur. “Ne presim që makineritë, pajisjet dhe projektet e mbështetura nga kjo skemë të shërbejnë si modele suksesi dhe frymëzim për të tjerët, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të vendit. Ministria do të mbetet partnere e juaja gjatë gjithë periudhës së zbatimit,” ka thënë Sulçevsi. Pas përfundimit të fjalimeve, u realizua nënshkrimi i kontratave ndërmjet MZHR-së dhe përfituesve të Skemës së Granteve PZHRB 2025, i cili u zhvillua në grupe.

ÇMIMET E KONSUMIT SHKUAN NË 4,5% VJETORE DHE 0,5% MUJORE

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin gusht 2025, viti bazë 2015=100. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4,5% në muajin gusht 2025, krahasuar me muajin gusht 2024. Inflacioni mujor ishte 0,5% në muajin gusht 2025. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4,5 % në muajin Gusht 2025 krahasuar me muajin Gusht 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: energjia elektrike (17,1%), pushime të organizuara (17,1%), kafja, çaji dhe kakao (16,7%), pemët (16,6%), mishi (12,4%), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit (10,7%), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (10,4%), perimet (9,7%), vajrat dhe yndyrat (8,6%), shërbimet hoteliere (8,2%), qumështi, djathi dhe vezët (8,2%), shërbimet ambulatore (7,3%), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (6,3%), pijet



alkoolike (6,2%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,7%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,3%),

shërbimet financiare (5,2%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (4,9%), buka dhe drithërat (4,7%), kujdesi personal (4,6%), peshqit (4,1%), mirëmbajtja dhe rregullimi i

vendbanimit (3,9%), prodhimet ushqimore (3,6%), furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (3,5%), duhani (3,4%), sheqeri, reçeli, mjalta,

çokollata dhe ëmbëlsirat (3,3%), gjërat personale (3,1%), këpucë (3,1%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (2,1%), veshje (2,1%), transporti rrugor i pasagjerëve (2,0%) dhe mobile dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dysHEMEJE (1,6%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 4,9 për qind në IHÇK-it. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: biletat e fluturimeve (-7,8%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-4,1%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (3,2%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4 për qind në IHÇK-it. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,5 % në muajin gusht 2025 krahasuar me muajin korrik 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (15,4%), qumështi, djathi dhe vezët (2,4%), perimet (1,2%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (0,8%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,5 për qind në IHÇK-it.

Bashkëpunim i ri mes ATK-së dhe AKI-së për sigurinë ekonomike të vendit

Prishtinë, 11 shtator- Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Mentor Hyseni, ka pritur në ambientet e ATK-së drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Petrit Ajeti, në një takim të parë zyrtar ndërmjet dy institucioneve. Ky takim shënon hapjen e një kapitulli të ri në bashkëpunimin institucional, me qëllim fuqizimin e përpjekjeve të përbashkëta për luftimin e dukurive negative që dëmtojnë

sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Bashkëpunimi mes ATK-së dhe AKI-së pritet të tejkalojë objektivin e ngushtë të parandalimit të evazionit fiskal, duke u shtrirë në adresimin e fenomeneve të tjera që rezikojnë integritetin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Të dy drejtuesit nënvizuan rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm, shkëmbimit të informacionit dhe forcimit të

kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e interesit publik. U theksua po ashtu se ky bashkëpunim do të kontribuojë në rritjen e transparencës, besimit qytetar dhe në ndërtimin e një sistemi më të drejtë e më të sigurt për të gjithë. Administrata Tatimore e Kosovës mbetet e përkushtuar që përmes partneriteteve të tilla strategjike të avancojë misionin e saj në shërbim të shtetit ligjor dhe të qytetarëve.



PESË MËSIMET NGA DRONËT E PUTINIT NË POLONI



Ka të paktën pesë mësimet që Evropa dhe SHBA-ja duhet të nxjerrin nga vendimi i paprecedentë i Rusisë për të lëshuar dronë në Poloni si pjesë e një vale tjetër masive kundër Ukrainës. Të gjitha kërkojnë ose një reagim të menjëhershëm, ose një rishikim të llogarive.

Së pari dhe më e rëndësishmja: Askush nuk duhet ta hedhë më poshtë si ide qesharake mendimin se Rusia — duke u gjendur kaq në vështirësi në Ukrainë — nuk do të guxonte të sulmonte ndonjëherë një vend anëtar të NATO-s. Ajo sapo e bëri këtë, pavarësisht pretendimit të Ministrisë së Mbrojtjes ruse të mërkurën se nuk kishte ndërmend të godiste ndonjë objektiv në Poloni. Nëntëmbëdhjetë dronë hynë në hapësirën ajrore polake, sipas ministrit të Jashtëm Radek Sikorski, mjaftueshëm për ta bërë të qartë se ishte një veprim i qëllimshëm dhe për t'i dhënë Polonisë të drejtën të aktivizojë nenin 4 të NATO-s, që thërret aleatët për konsultim, kur një anëtar është nën kërcënim. Sipas Fabian Hinz, nga Instituti Ndërkombëtar për Studime Strategjike në Londër, analiza e dronëve të rrëzuar deri më tani tregon se ishin të tipit Gerberas, një model i lirë me krahë fikse, i projektuar për ushtrinë ruse në Kinë. Këta shërbejnë për role të shumta, përfshirë si dronë sulmues dhe si mashtrues për

të mbingarkuar mbrojtjen e Ukrainës. Por më shumë se konfigurimi i dronëve të përdorur, ka rëndësi fakti që Vladimir Putini ka qenë i qartë që në fillim të luftës, se ai e sheh zgjerimin e aleancës perëndimore për të pranuar ish-vendet e bllokut sovjetik si një nga “shkaqet themelore” pas vendimit për të pushtuar një shtet fqinj. Për sa kohë që NATO nuk pranon kërkesat e tij, ai do të vazhdojë të shtyjë përpara — jo sepse i trembet një pushtimi nga Perëndimi, por sepse aleanca i kufizon hapësirën e ndikimit që ai është i vendosur t’ia rikthejë Moskës.

Së dyti, sulmi i natës tregon qartë faktin se Ukraina është vija e parë dhe më e fortë e mbrojtjes së Evropës kundër një Rusie hakmarrëse dhe revizioniste. Mjafton të imagjinojmë sikur Putini t’i arrijë në fund objektivat e tij në Ukrainë: të pushtojë — ose t’i dhurohen — të gjitha territoret nga Odesa në jug deri në Sumy në verilindje, ndërsa në Kiev të imponohet një qeveri pro-Moskës, për atë që mbetet përtej lumit Dnieper. Rasti i Bjellorusisë tregon qartë se Putini nuk i duhet ta pushtojë një vend për të vendosur raketat, trupat dhe mbrojtjen ajrore aty, as për të diktuar politikën ndaj fqinjëve që ai i konsideron të padisiplinuar. Inkursionet me

dronë, të lëshuara nga një distancë më e afërt — pra me më pak kohë reagimi për mbrojtjet e NATO-s — do të ishin vetëm një nga mjetet e shumta destabilizuese që ai do të kishte në dorë.

Së treti, siç shkruajti eksperti i fuqisë ajrore Phillips O’Brien, profesor i studimeve strategjike në Universitetin e St. Andrews, përdorimi nga NATO i avionëve dhe raketave tepër të kushtueshme për të rrëzuar vetëm disa nga dronët rusë që kaluan në hapësirën ajrore polake tregon se mbrojtjet e aleancës mbeten të papërgatitura edhe pas katër vitesh lufte pranë kufirit. “Zoti i ndihmoftë, nëse përballen me 600 dronë e raketa në një natë të vetme,” siç ndodh rregullisht për Ukrainën, shkroi ai. Tani lind pyetja: a do ta humbiste rastin Putini — i cili tashmë e ka riorientuar ekonominë e Rusisë për luftë dhe ka testuar kufijtë e vullnetit dhe kapacitetit të Evropës për t’i rezistuar — për të përdorur këto mjete?



Së katërti, kjo luftë ka treguar se Putini nuk i duhet të pushtojë një vend për ta sulmuar. Kjo mund të bëhet përmes sulmeve kibernetike, sabotimeve, apo me raketa e dronë të lëshuar në sasi që vetëm pak vite më parë do të dukeshin të paimagjinueshme. Rusia nuk

ka nevojë të jetë ngjitur me një shtet për ta goditur atë, edhe pse kjo ia shton opsionet. Në fakt, as nuk ka nevojë të pushtojë për të testuar NATO-n dhe për të vënë në dyshim seriozitetin e nenit IV, që është baza e mbrojtjes kolektive. Ky testim tashmë ka filluar me atë që O’Brien e quajti sulmi “me rrota ndihmëse” ndaj Polonisë. Reagimi i SHBA-së tani — qoftë me një angazhim absolut dhe të qartë për mbrojtjen e Polonisë, ose me diçka më pak se kaq — do të jetë kritik. Ky do të përcaktojë nëse Putini tërhiqet pasi e mori përgjigjen, apo nëse do të provojë më tej për të gjetur dobësi të tjera që do të ekspozojnë dhe shkatërrojnë aleancën, duke ndryshuar llogaritë gjeopolitike në gjithë Evropën. Pa një angazhim domethënës të SHBA-së për sigurinë, Putini do të ishte në prag të suksesit atje ku paraardhësit e tij në Kremlin — deri te Josif Stalini — dështuan: ndarja e Uashingtonit nga Evropa dhe shndërrimi i Rusisë në fuqinë kryesore ushtarake të kontinentit evropian.

Dhe në fund, sulmi me dronë ndaj njërit prej shteteve më të armatosura të NATO-s tregon efektin gërryes të mungesës së kapaciteteve ushtarake të Evropës dhe mungesës së vullnetit politik të SHBA-së. Ky kombinim i ka dhënë

mundësinë Rusisë të marrë iniciativën në Ukrainë këtë vit. Duhej të kishte qenë presidenti amerikan Donald Trump dhe aleatët e Kievit në Evropë e Azi ata që do të rritnin presionin ekonomik e ushtarak ndaj Rusisë, duke e detyruar Kremlinin në negociata për një fund të qëndrueshëm të luftës. Në vend të kësaj, është Putini — i sigurt në aleancat e tij me Kinën, Iranin dhe Korenë e Veriut — ai që po shton presionin mbi Ukrainën dhe mbështetësit e saj. Shpresa e tij është që aleatët e Kievit ose ta braktisin Ukrainën, ose ta detyrojnë të dorëzohet përballë objektivave të tij dhe ekuilibrit të ri të fuqive në Evropë, që do të vijë më pas.

Kjo ishte vetëm një e shtënë paralajmëruese. Asnjë nga këto skenarë ekstremë nuk është i pashmangshëm për shkak të dy faktorëve: Ukraina ka një forcë të armatosur — dhe në këtë pikë edhe një kapacitet prodhues për dronë dhe armë të tjera kritike — që asnjë shtet evropian në perëndim nuk mund ta rivalizojë në afatin e afërt ose të mesëm. Dhe Evropa — kur mbështetet nga SHBA-ja — ende ka mjaftueshëm burime për ta ndihmuar këtë forcë të ndalë Putinin brenda kufijve të Ukrainës. Topi i dronëve tani është drejtpërdrejt në fushën e NATO-s. / Bloomberg – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot hidhet shorti për edicionin e ri të basketbollit në Kosovë

Sot (e premte), në ambientet e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), do të hidhet shorti për edicionin e ri garues në basketbollin vendor. Procesi i

tërheqjes së shortit nis në orën 11:00 me Superligën e Femrave, ndërsa nga ora 12:00 do të vazhdohet me ProCredit Superligën e Meshkujve. Ky

edicion pritet të sjellë një nivel të lartë rivaliteti dhe cilësie, me shumë skuadra që e kanë shpallur synim titullin e kampionit. Tifozët dhe adhuruesit e basketbollit do të

kenë mundësinë të ndjekin muaj me duele emocionuese, ndeshje të forta dhe spektakël të vërtetë në parket. Federata e Basketbollit ka bërë të ditur se shorti do të

transmetohet drejtpërdrejt në faqen zyrtare të FBK-së në “Facebook”, duke u mundësuar të gjithë të interesuarve ta ndjekin në kohë reale.

ZHEGROVA PREZANTOHET TE JUVE: PËRFAQËSOJ TË GJITHË SHQIPTARËT

TORINO, 11 GUSHT (ER) - Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Edon Zhegrova të enjten është prezantuar si lojtar i Juventusit. Anëtori “dardan” për herë të parë ka folur si lojtar i “Zonjës së Vjetër”, pas transferimit të tij të shumëpritur në Torino. Zhegrova para mediave italiane dhe shqiptare, ka ndarë emocionet e tij për këtë hap të rëndësishëm në karrierë dhe duke treguar për mikpritjen që ka gjetur në ambientin e ri bardhezi. “I jam shumë mirënjohës klubit për mirëseardhjen. Jam i lumtur dhe krenar që jam këtu. Këto ditë të para kanë qenë fantastike, të gjithë – stafi dhe shokët e skuadrës – më kanë pritur në mënyrë të jashtëzakonshme. Padyshim një përshlyetje shumë pozitive”, ka thënë Zhegrova me një buzëqeshje të sinqertë, duke e bërë të qartë se ndjehet tashmë si pjesë e një familjeje të madhe. Zgjedhja për t’u bashkuar me “Zonjën e Vjetër” nuk ishte rastësi për 25-vjeçar, i cili tregoi se projekti sportiv dhe atmosfera brenda klubit ishin vendimtare për vendimin e tij. “Projekti i Joves më bindi. E njihja David që më parë. Kjo është një skuadër me shumë cilësi dhe unë jam i bindur që mund të jap kontributin tim”, ka shtuar ai, duke nënvizuar se skuadra ka një bazë të fortë për të ndërtuar sukses në të gjitha garat. Zhegrova komentoi gjithashtu për gjendjen e tij fizike, pas një periudhe të vështirë për shkak të një dëmtimi që e mbajti jashtë fushave për disa javë. Ai siguroi tifozët e Juventusit se është në rrugën e duhur për rikuperim dhe është i motivuar për të dhënë



maksimumin. “Kam kaluar një periudhë të vështirë për shkak të dëmtimit, por tashmë kam filluar të stërvitem fort me stafin. Shumë shpejt do të jem gati 100%,” ka thënë Zhegrova me vendosmëri, duke lënë të kuptohet se debutimi i tij nuk do të vonojë shumë. Objektivat e tij me Juventusin janë ambicioze, siç i ka hije një klubi me histori të pasur dhe pritshmëri të larta. “Ky ekip ka shumë cilësi. Synimi ynë është të fitojmë çdo ndeshje dhe të arrijmë sa më lart”, u shpreh Zhegrova, duke lënë të kuptohet se nuk do të kënaqet me pak. Një moment interesant gjatë konferencës për shtyp ishte kur Zhegrova u pyet për pasaportën shqiptare dhe kontaktet me kryeministrin Edi Rama, i cili ka

ndihmuar drejtpërdrejt në këtë proces. “Ai është një mbështetës i madh i Juventusit. Ishte shumë i kënaqur dhe i lumtur. Donte që të ma jepte pasaportën shqiptare ndaj dhe më ndihmoi shumë në këtë rast. I jam shumë mirënjohës. Më dha këtë pasaportë sepse unë përfaqësoj të gjithë komunitetin shqiptarë dhe jam shumë e rëndësishme dhe sigurisht që do t’i japë fanellën e parë”, ka deklaruar Zhegrova me mirënjohje për ndihmën që ka marrë. Me një kombinim të talentit, përkushtimit dhe vullnetit për të përfaqësuar jo vetëm veten por edhe një komunitet të tërë, Edon Zhegrova duket i gatshëm të shkëlqejë në fanellën bardhezi dhe të shkruajë një kapitull të ri të suksesshëm në karrierën e tij futbollistike.

Shkurt

Oltion Bilalli rikthehet në stërvitje pas katër muajsh

Pas katër muajsh mungesë për shkak të lëndimit të pësuar në ndeshjen ndaj Malishevës (0-0), futbollisti i Gjilanit, Oltion Bilalli u rikthye në stërvitje.

Ai u godit pa dashje me bërryl gjatë një dueli me portierin Ilir Avdyli në minutat e fundit të ndeshjes dhe më pas u përplas me kokë në tokë, duke pësuar gjakderdhje në kokë. Bilalli, dikur pjesë e Kosovës U21, qëndroi për disa javë në kujdesin mjekësor në QKUK, për tu liruar pastaj. Rikthimi në stërvitje, tregon përmirësime të dukshme në gjendjen e tij shëndetësore, pasi ai ka filluar vrapimet dhe përgatitjet për tu bashkuar pastaj me pjesën tjetër të ekipit. “Pas katër muajsh të vështirë, plot sfida dhe sakrifica, jam rikthyer në fushë. Çdo ditë e kaluar në rikuperim ka qenë një betejë. Sot, më në fund jam kthyer aty ku i përkas – në fushë. Faleminderit të gjithëve që ishit pranë meje”, ka shkruar Bilalli.

Atletja Gresa Bakraçi përfaqëson Kosovën në ‘Tokyo 2025’

Atletja Gresa Bakraçi do të përfaqësojë Kosovën në Kampionatin Botëror të Atletikës, që do të mbahet në Tokio të Japonisë, nga 13 deri më 21 shtator. Gresa do të garojë në disiplinën 1500 metra, me garën e saj të parë që zhvillohet më 13 shtator 2025. Shpresat janë të mëdha për një paraqitje dinjitoze dhe kualifikim në gjysmëfinale. Gresës në këtë ngjarje të madhe i janë bashkuar edhe përfaqësuesit e Federatës Atletike të Kosovës: Halil Sylejmani, kryetar i Federatës Atletike të Kosovës dhe Arta Kelmendi, anëtare e Kryesisë së FAK. Të dy do të marrin pjesë në Kongresin e 55-të të Atletikës Botërore (World Athletics Congress), i cili do të zgjasë tri ditë dhe përbën një ngjarje të rëndësishme për të ardhmen e atletikës botërore dhe asaj kosovare.

Turneu ‘Peja International Preseason Tournament’ me skuadra elitare evropiane

Klubi Peja 03 është mikpritës i turneut ndërkombëtar me skuadra elitare para fillimit të edicionit të ri. Turneu do të organizohet më 13, 14 dhe 15 shtator në Rahovec, Prishtinë dhe Pejë. Përveç klubit të Peja 03, do të marrin pjesë edhe Beshiktashi i Turqisë, Nyoni i Zvicrës dhe ZKK Play Off Sarajevo i Bosnje e Hercegovinës. Adhuruesit e basketbollit për tri ditë me radhë në tri qytete të ndryshme të Kosovës do të mund të shohin basketboll mjaft cilësor nga skuadra elitare evropiane. Të shtunën në Palestra Sportive “Mizahir Isma” në Rahovec do të përballen: Peja 03-Nyon (17:00), ZKK Play Off-Beshiktash (19:30). Në Sallën e Sporteve 1 Tetori në Prishtinë të dielën do të përballen: Beshiktash-Peja 03 (17:00), Nyon-Play Off (19:30), kurse Të hënën në Pejë përballen: Beshiktash-Nyon (12:00) dhe Peja 03-ZKK Play Off (14:30).

Të shtunën spektakël hendbolli në Ferizaj, zhvillohen dy finalet e Superkupës

Ferizaj, 11 shtator - Palestra “Bill Clinton” në Ferizaj të shtunën do të jetë arena e dy përballjeve vendimtare për Superkupën e Kosovës në hendboll, ku katër skuadrat më të mira në vend do të synojnë trofetë e radhës. Nga ora 17:30, nis sfida mes Istogut dhe Ferizajt në konkurrencën

e femrave. Dy skuadrat, të njohura për rivalitetin e fortë dhe cilësinë e lartë të lojës, do të matin forcat për një nga trofetë më të rëndësishëm të sezonit. Mbrëmja kulmon me përballjen e shumëpritur në konkurrencën e meshkujve. Në orën 20:00, Rahoveci dhe Kastrioti do të zbresin në

parket për të vendosur fituesin e Superkupës. Të dy ekipet kanë shfaqur formë të shkëlqyer dhe synojnë me ngulm trofeun, duke premtuar një ndeshje spektakolare. Një e shtunë e mbushur me emocion, adrenalinë dhe hendboll cilësor pret të gjithë sportdashësit në Ferizaj.



Verstappen: Jam i sigurt që Yamal në të ardhmen do të fitojë ‘Topin e Artë’

BARCELONË, 11 SHTATOR - Max Verstappen, katër herë kampion bote në Formula 1, në një intervistë për gazetën spanjolle “El Mundo Deportivo”, foli jo vetëm për sportin e tij, por edhe për futbollin dhe klubin e zemrës, Barcelona. Piloti holandez rikujtoi se edhe verën e kaluar

kishte besim te emërimi i Hansi Flick për të drejtuar katalanasit dhe komentoj mundësitë e talentit të ri, Lamine Yamal, për të fituar “Topin e Artë”. “Edhe verën e kaluar kisha besim te Barça, por ndonjëherë ndjeva pak shqetësim, sepse rivaliteti mes Barcelonës dhe Real Madridit

është gjithmonë i fortë. Megjithatë, më pëlqen stili i lojës me Flick; është shumë ofensivë dhe ndonjëherë merr rreziqe në mbrojtje. Por, deri tani, po funksionon mirë”, ka thënë Verstappen. Ai ka shtuar se ajo që po bën Yamal është e jashtëzakonshme për moshën e tij dhe shprehu bindjen se

talenti i ri do të arrijë suksesin më të madh: “‘Topi i Artë’ jepet për më të mirin dhe pas epokës së Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo nuk ka ende një fitues të qartë. Por jam i sigurt që Yamal do të fitojë ‘Topin e Artë’ në vitet e ardhshme”, ka përfunduar Verstappen.



FFK-ja nis për herë të parë kursin për Licencën UEFA – B për trajnerët e portierëve

PRISHTINË, 11 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës ka filluar për herë të parë kursin për trajnerët e portierëve UEFA GK–B, i cili do të zgjasë deri në prill të vitit 2026. Ky kurs ka nisur me fazën e parë të ligjëratave, ku para 16 kandidatëve kanë ligjësuar instruktorët e UEFA-s, Frank Thieltges nga Gjermania dhe Tomislav Butina nga Kroacia. Në kuadër të këtij kursi, kandidatët do të ndjekin jo vetëm ligjërata teorike, por edhe punë praktike, monitorime në klube dhe në fund do t'i nënshtrohen provimeve përfundimtare. Instruktori i UEFA-s, Frank Thieltges, vlerësoi këtë hap si shumë të rëndësishëm për futbollin kosovar. “Për herë të parë në Kosovë kemi një licencë B për trajnerët e portierëve. Ky është një zhvillim që ndihmon në bashkëpunimin më të madh mes trajnerit të ekipit dhe trajnerit të portierëve. Është e rëndësishme që trajnerët e portierëve të jenë më të përfshirë në stërvitjet e



ekipit dhe kjo është rruga e duhur përpara”, tha ai. Ndërsa instruktori kroat, Tomislav Butina, u shpreh i impresionuar nga niveli i kandidatëve kosovarë. “Siç mund të shihet, në këtë kurs ka shumë përvojë dhe trajnerë të mirë nga Kosova, veçanërisht në rolin e trajnerëve të portierëve. Përparimi që arritën brenda vetëm dy ditëve ishte shumë më i madh sesa pritej. Mund të them se ky është një kurs shumë i suksesshëm”, ka thënë ai. Njëri nga pjesëmarrësit, Valmir Bytyqi, u shpreh i entuziazmuar për këtë mundësi. “Janë duke u shfaqur njohuri të reja dhe mënyra të punës shumë të evoluara me futbollin modern,

ku pjesë e rëndësishme është edhe portieri. Jam shumë i lumtur që jam duke marrë pjesë në këtë kurs dhe tek të gjithë shihet një entuziazëm i madh. Ne jemi grupi i parë që ndjekim këtë kurs, i cili ka qenë shumë i nevojshëm dhe do të na shërbejë shumë në të ardhmen”, ka deklaruar ai. Ndërkohë, pjesëmarrësja tjetër, Diellza Musa, theksoi rëndësinë e përvojës së ndarë nga instruktorët. “Kam kënaqësinë që po dëgjoj përvoja nga instruktorë shumë profesionalë dhe besoj se këto instruksione do të na shërbejnë në punën tonë, qoftë me gjeneratat e reja, por edhe me ekipet profesionale”, ka pohuar ajo. Ky kurs po vlerësohet si një hap i madh përpara në zhvillimin profesional të trajnerëve të portierëve në Kosovë dhe është pjesë e strategjisë së Departamentit të Edukimit në FFK drejt ngritjes së standardeve në futbollin e Kosovës.

Gjermania mposhti Slloveninë dhe kalon në gjysmëfinale

BERLIN, 11 SHTATOR - Gjermania ka arritur të kualifikohet në gjysmëfinalet e Eurobasket pas një fitoreje të madhe kundër Sllovenisë me rezultat 99:91. Ndeshja nisi më mirë për sllovenët, të cilët fituan çerekun e parë me rezultat 32:21. Loja ishte e shpejtë dhe e ngjeshur me shumë shporta të njëpasnjëshme, ndërsa në minutat e fundit të pjesës së parë Sllovenia realizoi një seri prej 11 pikësh që i dha epërsi për pjesën tjetër të ndeshjes. Megjithatë, në pjesën e dytë gjermanët u rikthyen fuqishëm. Të udhëhequr nga Franz Wagner dhe Dennis Schroder, ata e kontrolluan lojën dhe e kthyen



rezultatit në favorin e tyre. Gjermania shkoi në pushim me epërsi të lehtë 45:14. Çereku i tretë solli një lojë të balancuar dhe përfundoi me një gjuajtje të saktë për tri pikë nga gjermanët me tingullin e sirenës, duke mbajtur gjallë pasigurinë e rezultatit. Në çerekun e fundit Gjermania shpërtheu. Me një seri 12:3 në fillim, ata morën kontrollin total të lojës. Sllovenia

humbi përqendrimin dhe nuk pati efikasitet nga distanca, ndërsa gjermanët e menaxhuan më mirë ndeshjen për ta mbyllur me triumf dhe për të siguruar kalimin në gjysmëfinale. Luka Donçiq ishte përsëri i pandalshëm për Slloveninë, duke shënuar plot 39 pikë, indjekur nga Klemen Prepelic me 13 dhe Gregor Horvat me 9 pikë. Për Gjermaninë spikati Franz Wagner me 23 pikë, ndërsa Dennis Schroder shtoi 20 dhe Daniel Theis kontribui me 15 pikë. Gjermania tani do të përballet me Finlandën në gjysmëfinale, ndërsa gjysmëfinalja tjetër do të zhvillohet mes Turqisë dhe Greqisë.

SHKURT

Eriksen i bashkohet Wolfsburgut

Mesfushori i njohur danez, Christian Eriksen, është transferuar zyrtarisht te klubi gjerman Wolfsburg. Lajmi është konfirmuar nga vetë klubi nëpërmjet një njoftimi në rrjetet sociale, duke e bërë Eriksen përforcimin më të ri të skuadrës për sezonin e ri në Bundesliga. Për Eriksen, ky është një kapitull i ri në karrierën e tij, pasi për herë të parë do të luajë në kampionatin gjerman. Ai ka një përvojë të pasur ndërkombëtare, duke qenë më parë pjesë e Ajaxit në Holandë, Tottenhamit në Angli dhe Interit në Itali. “Jam i lumtur që do të jem pjesë e Wolfsburgut. Pres me padurim të filloj këtë aventurë të re dhe të ndihmoj skuadrën të arrijë objektivat,” u shpreh Eriksen gjatë prezantimit të tij. Mesfushori 33-vjeçar mund të bëjë debutimin e tij në ndeshjen e Wolfsburgut ndaj Kolnit në Bundesliga.

Federata angleze ngrit 74 akuza kundër Chelseat

Federata e Futbollit në Angli ka goditur Chelsean me 74 akuza. Të gjitha lidhen me një periudhë 12-vjeçare ku pronar i klubit ishte Roman Abramovich. Federata akuzon Chelsean për shkelje të rregullave, që lidhen me agjentët dhe investimet e palëve të treta te lojtarët. Klubit londinez ndërkohë iu dha kohë deri më 19 shtator, për t'u përgjigjur. Chelsea nuk vonoi aspak me deklaratën. Klubi tregoi se çështjet janë raportuar nga vetë grupi i pronarëve, që blenë Chelsea në vitin 2022. “Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për Federatën për angazhimin e saj me klubin në këtë çështje komplekse, e cila ka të bëjë me ngjarje që kanë ndodhur më shumë se një dekadë më pare”, mbyllet deklarata e Chelseat.

Tifozët serbë kërkojnë largimin e trajnerit, ndeshja me Shqipërinë vendimtare

Dragan Stojković po kalon momente të vështira në stolin e Serbisë. Tekniku ka përfunduar në shënjestër të tifozëve, të cilët e kanë akuzuar për humbjen e thellë ndaj Anglisë. Pas disfatës 5-0, tifozët kanë shkarkuar largimin e Stojkovićit, i cili duket se nuk ka ndërmend të jap dorëheqje. Ndeshja me Shqipërinë muajin e ardhshëm do të jetë vendimtare për të ardhmen e teknikut 60-vjeçar. Një tjetër humbje për Serbinë ndaj kuqezinjve, do të komplikonte situatën në grup dhe shkarkimi i trajnerit do të ishte i pashmangshëm.

Superkompjuteri zbulon fituesin e Ligën e Kampionëve

Favoritët e përgjithshëm në këto llogaritje janë Liverpooli, të cilit i jepet një shans prej 20.4% për të fituar, i ndjekur nga Arsenali me 16% dhe

kampionët në fuqi PSG me 12.1%. Superkompjuteri Opta ka bërë parashikimet e tij për Ligën e Kampionëve të këtij sezoni të ri futbolistik, duke e

nxjerrë Liverpoolin si favorit. Favoritët e përgjithshëm në këto llogaritje janë Liverpooli, të cilit i jepet një shans prej 20.4% për të fituar, i ndjekur nga Arsenali me

16% dhe kampionët në fuqi PSG me 12.1%. Manchester City renditet i katërti me 8.4% shanse, njësoj si Barcelona. Renditja e parashikimit vazhdon

me Chelsean, Realin dhe Bayernin. Për sa i përket skuadrave italiane, Interit i jepet 3% shanse, Napolit 1.4. Ndërsa Juventus dhe Atalanta 0.6%.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOGSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Prishtinë, 11.09.2025

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimor-shkencor (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 45, 47 dhe 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 60/25 të datës 08.04.2025 për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të Punës nr. 03/L212, vendimit nr.88/25 të datës 10.09.2025, Këshilli Shkencor i Institutit, shpallë:

KONKURS
për ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE - AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE
TË HULUMTUESVE

I (Një) Hulumtues në fushën e Edukimit/Pedagogjisë së Përgjithshme (ZGJEDHJE)

- Departamenti kërkimor-shkencor (Divizionet AMU, AML)
- Klasa E11, koeficienti 7.60

Përshkrimi i punëve:

- Planifikon dhe realizon hulumtime shkencore në fushën e edukimit, pedagogjisë së përgjithshme dhe digjitalizimit në arsim.
- Përpunon dhe analizon të dhënat duke përdorur metoda cilësore dhe sasore, si dhe programe statistikore (p.sh. SPSS).
- Harton raporteve shkencore, artikuj dhe botime për revista relevante kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Kontribon në shkrimin dhe menaxhimin e projekteve të IPK-së, përfshirë aplikimet për fonde në organizata vendore e ndërkombëtare.
- Bashkëpunon me departamente të tjera të institutit dhe me partnerë të jashtëm për projekte dhe hulumtime të përbashkëta.
- Promovon përdorimin e teknologjisë dhe digjitalizimit në arsim përmes projekteve dhe iniciativave të reja.
- Harton planin individual të punës kërkimore-shkencore dhe profesionale;
- Përgatit raport për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

Kandidati për hulumtues duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë të përfunduara studimet bachelor dhe ato master në drejtimin e Edukimit/Pedagogjisë së Përgjithshme;
- Të jetë jo më i vjetër se 27 vjet kur zgjedhet për herë të parë;
- Të ketë notën mesatare së paku tetë (8) në studimet bachelor dhe ato master;
- Të ketë njohuri profesionale të gjuhës angleze (me shkrim dhe të folur)
- Të ketë përvojë të dëshmuar për punën dhe aktivitetet shkencore nga fusha e kërkuar me konkurs;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për punën profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs;
- Përparësi do të kenë kandidatët me së paku një punim shkencor të botuar në një revistë relevante ndërkombëtare, si dhe përvojë në mësimdhënie në nivelin AMU/AML.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Dëshmi për përfundimin e studimeve bachelor dhe master nga fusha Pedagogji/Edukim;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze, së paku niveli B1 i CEFR (Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencës për Gjuhët – CEFR);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dëshmi të lëshuar nga Gjykata kompetente, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar;
- CV-në e përditësuar, së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Dëshmi tjera për përvojën profesionale nga fusha përkatëse (p.sh. përvoja e punës në mësimdhënie në nivelin AMU/AML.);
- Dëshmi tjera për punën dhe të arriturat shkencore (p.sh. artikuj, libra, monografi, konferenca shkencore, etj) nga fusha përkatëse;
- Të gjitha dëshmitë duhet të përgatiten sipas shtojcës I dhe II e cila gjendet në Rregulloren për Zgjedhjen dhe Rizgjedhjen e punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve të Institutit;
- Për gradat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzohet vendimi për njohje të diplomës nga zyra e NARIC në MASHTI;
- Kandidatët me rastin e aplikimit dokumentacionit i bashkëngjisin kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të tij në faqen zyrtare të Institutit në internet, në harmoni me Rregulloren për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes së punëtorëve shkencore dhe hulumtuesve.

Zgjedhja e personelit shkencor të Institutit Pedagogjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore - shkencore, të Statutit të Institutit Pedagogjik dhe të Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve. Pozita është me mandat 3 vjeçar me mundësi ri-zgjedhje, zgjedhje apo avancim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/20020169, prej orës 08:00 - 16:00.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në adresën: Instituti Pedagogjik i Kosovës në Prishtinë, (Pejton, rruga "Lorenc Antoni", nr. 38).



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOGSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Priština, 11.09.2025.

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o istraživačko-naučnoj delatnosti (Službeni list Republike Kosova, br. 11/02. maj 2013.), člana 45., 47. i 48. Statuta Pedagoškog instituta Kosova u Prištini, Uredbe br. 60/25 dana 08.04.2025. o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača u Pedagoškom institutu Kosova, Zakona o radu br. 03/L212, odluke br. 88/25 dana 10.09.2025., Naučni savet Instituta raspisuje:

KONKURS
ZA IZBOR, PONOVI IZBOR - UNAPREĐENJE NAUČNIH RADNIKA I
ISTRAŽIVAČA

I (jedan) istraživač u oblasti Vaspitanja/Opšte pedagogije (IZBOR)

- Istraživačko-naučni departman (Divizije NSO, VSO)
- Klasa E11, koeficijent 7.60

Opis posla:

- Planira i realizuje naučna istraživanja u oblasti vaspitanja, opšte pedagogije i digitalizacije u obrazovanju.
- Obraduje i analizira podatke koristeći kvalitativne i kvantitativne metode, kao i statističke programe (npr. SPSS).
- Izrađuje naučne izveštaje, članke i publikacije za relevantne nacionalne i međunarodne časopise.
- Doprinosi pisanju i upravljanju projektima PIK-a, uključujući apliciranja za fondove u domaćim i međunarodnim organizacijama.
- Saraduje sa drugim departmanima instituta i sa spoljnim partnerima za zajedničke projekte i istraživanja.
- Promoviše upotrebu tehnologije i digitalizacije u obrazovanju kroz nove projekte i inicijative.
- Izrađuje individualni plan istraživačko-naučnog i stručnog rada;
- Priprema izveštaj o realizovanim radovima;
- Obavlja i druge poslove koje mu delegira rukovodilac departmana i Direktor.

Kandidat za istraživača mora da ispunjava ove uslove:

- Da ima završene bachelor i one master studije u smeru vaspitanja/Opšte pedagogije;
- Da ne bude stariji od 27 godina kada se po prvi put izabere;
- Da ima prosečnu ocenu najmanje osam (8) na bachelor i onim master studijama;
- Da ima stručno znanje engleskog jezika (pismeno i govorno);
- Da ima dokazano iskustvo u radu i naučnim aktivnostima iz oblasti zahtevane konkursom;
- Da ima dokazano iskustvo za stručni rad iz oblasti zahtevane konkursom;
- Prednost će imati kandidati sa najmanje jednim naučnim radom objavljenim u relevantnom međunarodnom časopisu, kao i iskustvom u nastavi na nivou NSO/VSO.

Potrebna dokumentacija

Kandidat/kinja mora dostaviti dokumentaciju kao u nastavku:

- Dokaz o završenim bachelor i master studijama iz oblasti Pedagogije/Vaspitanja;
- Dokaz o poznavanju engleskog jezika, najmanje nivo B1 CEFR-a (Zajednički evropski referentni okvir za jezike - CEFR);
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci;
- Dokaz izdat od Nadležnog suda, putem kojeg se dokazuje da kandidat nije osuđen;
- Ažurirani CV, kojim se moraju priložiti potrebni dokazi koji dokazuju stanje prikazano u njemu;
- Drugi dokazi o stručnom iskustvu iz odgovarajuće oblasti (npr. radno iskustvo u nastavi na NSO/VSO nivou);
- Ostali dokazi o naučnom radu i dostignućima (npr. članci, knjige, monografije, naučne konferencije itd.) iz odgovarajuće oblasti;
- Svi dokazi moraju biti pripremljeni prema Prilogu I i II koji se nalaze u Uredbi o izboru i reizboru naučnih radnika i istraživača Instituta;
- Za stečene stepene u inostranstvu, mora se dostaviti odluka o priznavanju diplome od kancelarije NARIC u MONTI;
- Kandidati prilikom apliciranja, prilažu kopije dokumenata o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje konkurišu.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Instituta na internetu, u skladu sa Uredbom o postupcima izbora, reizbora naučnih radnika i istraživača.

Izbor naučnog osoblja Pedagoškog instituta vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 o istraživačko-naučnoj delatnosti, Statuta Pedagoškog instituta i Uredbe o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača. Pozicija je sa mandatom od 3 godine sa mogućnošću reizbora, izbora ili unapređenja.

Kandidati izabrani u užu spisak biće informisani pismeno ili telefonom u zakonskom roku od Instituta, i obavezni su da sa sobom donesu originalne dokumente o obavljenim kvalifikacijama i obukama na verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na ovaj br. tel: 038/20020169, od 08:00 - 16:00 časova.

Kompletirana dokumentacija se dostavlja na adresu: Pedagoški institut Kosova u Prištini, (Pejton, ulica "Lorenc Antoni", br. 38).

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

